Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia Akademike:	**Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi:	**Arkitektura e Intrierit dhe Dizajni i Mobilieve**
Titulli i lëndës:	**Teknologjia dhe Digjitalizimi i Prodhimit**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**II**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**5**
Koha / lokacioni:	**USHAF**
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Njohuri mbi bazat e teorisë së prerjes dhe përpunimit mekanik. Makinat teknologjike konvencionale për sharrim, zdrugim, shpim, frezim, zumparim, përkulje, presim etj. Karta teknologjike dhe fluksi teknologjik në repartin e prodhimit të mobilieve. Sistemet e prodhimit, sistemet e komunikimit dhe standardet për Industrinë 4.0. Makinat CNC dhe aplikimi i tyre në prodhim e mobilieve dhe elmentëve të interierit. Shpërndarja dhe normimi i punës në repartet e prodhimit.
Qëllimet e lëndës:	Pajisja e studentët me njohuritë themelore për makinat për përpunimin e drurit, renditjen e tyre sipas fluksit teknologjik, normimin dhe ndarjen e punës. Përgatitja e studentëve për digjitalizimin e prodhimit industrial dhe sistemet e linjës së prodhimit me makineri moderne të cilat shërbejnë për prodhim në industrinë e drurit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	*Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:* • *Të dijë për bazat e teorisë së prerjes së drurit, forcën dhe fuqinë e prerjes, punën specifike.*

	• *Të dijë për makinat konvencionale për përpunimin mekanik.* • *Radhitjen e makinat në linjë teknologjike dhe normimin e punës.* • *Të njohë dhe kuptojë industrinë SMART;* • *Të planifikojë dhe zbatojë në kohë projekte teknike në makinat CNC;* • *Aftësi për përdorur makinat kryesore CNC në repartin e prodhimit të mobilieve.*

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit e studentit)

Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	3	2	6
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	7	7
Ushtrime në teren	3	2	6
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	9	27
Përgatitja përfundimtare për provim	2	13	26
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet ,etj	-	-	
Totali			**125**

Metodologjia e mësimdhënies:	*Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste te studimit dhe diskutime në klasë dhe punë praktike në fabrikat të cilat merren me këtë veprimtari*
Metodat e vlerësimit:	*Vlerësimi:* *Provimi përfundimtar 60%,* *Punim seminarik 40%*
Literatura	
Literatura bazë:	*1. Osman O. ''Makinat dhe Instrumentat Prerëse'' Prishtinë*

	2. Marku P., Dimoshi S. ''Teknologjia e Përpunimit Mekanik të Drurit'' Tiranë 2004 *3. Shaping the Fourth Industrial Revolution by Klaus Schwab Satya Nadella Nicholas Davis* *4. Steve K.& Arthur G. Computer Numerical Control CNC*
Literatura shtesë:	*1. Dimoshi S. ''Makinat dhe Instrumentat Prerës'' Tiranë 2001.* *2. Elena G. Popkova, Yulia V. Ragulina, Aleksei V. Bogoviz (2019), Industry 4.0: Industrial Revolution othe 21st Century.* *3. Osmani O. ''Teknologjia e finalizimit të drurit'' Prishtinë*

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë:	**Njohja me lëndën. Bazat e teorisë së prerjes së drurit**
Java e dytë:	**Veglat për përpunimin e drurit. Forca dhe fuqia e prerjes**
Java e tretë:	**Makinat për sharrimin dhe gdhendjen e drurit**
Java e katërt:	**Makinat e frezimit dhe shpimit**
Java e pestë:	**Makinat e tornimit, zumparimit, presimit etj.**
Java e gjashtë:	**Kartat teknologjike të përpunimit mekanik dhe fluksi teknologjik i prodhimit**
Java e shtatë:	**Bazat teorike të teknologjisë së përpunimit mekanik të drurit**
Java e tetë:	**Aspektet kryesore të digjitalizimit të prodhimit**
Java e nëntë:	**Sistemet inteligjente dhe teknologjitë për mundësimin e Industrisë së digjitalizuar**
Java e dhjetë:	**Organizimi i linjave teknologjike të prodhimit - Punë praktike në laboratorin e USHAF**
Java e njëmbëdhjete:	**Aplikimi i programeve softuerike në makinat CNC**
Java e dymbëdhjetë:	**Identifikimi i makinave në bazë të manipulimit të bankave dhe akseve (axis X,Y,Z**
Java e trembëdhjetë:	**Softueri i makinës CNC (G-Kodet, Driverët etj.)**
Java e katërmbëdhjetë:	**Bazat e programimit dhe aplikimi i programeve në CAD/CAM**
Java e pesëmbëdhjetë:	**Dorëzimi i punimit seminarik (projektit të kursit)**

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.